



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite
Ministry of Labour and Social Welfare

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA-VLADA-GOVERNMENT	
MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE	
Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite-Ministry of Labour and Social Welfare	
Sektor i Arkiv-Sektor Archive-Archive Sector	
Ajësia Org. Org. Jedinita Org. Unit	Nr. Prot: Grë, Prot: 22
Nr. fletëve Br. strahica 05	Prot. No:
No. pages	Data: 22.01.19
	Date:
Prishtine-Prishtina-Prishtina	



Komuna e Suharekës
Opština Suva Reka
Municipality of Suharekë

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

mes

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE (MPMS)
AGJENCIA E PUNËSIMIT E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (APRK)

dhe

KOMUNA E SUHAREKËS

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale /Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga z. Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MPMS.

dhe

Komuna e Suharekës, e përfaqësuar nga z. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës

lidhin këtë marrëveshje bashkëpunimi sipas dispozitave në vijim:

Neni 1

Hyrje

Duke ju referuar Ligjit 05/L-077 dhe Ligjit nr 04/L-205, dhe me qëllim të krijimit të partneritetit me akterët e tjerë palët e sipërpërmendura pajtohen që të bashkëpunojnë rreth realizimit të masës praktikë në punë konform Rregullores 01/2018, për masat aktive të tregut të punës lidhur me realizimin e kësaj mase aktive të tregut të punës.

Neni 2

Qëllimi

- 1) Qëllimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit, është realizimi i masës aktive praktikë në punë për 15 (pesëmbdhjet) punëkërkues, për një periudhë kohore prej 6 (gjashtë) muaj, me mundësi vazhdimi përmes bashkëpunimit të MPMS/APRK në kuadër të së cilës janë: QAP-Qendrat e Aftësimi Profesional, dhe ZP-Zyrat e Punësimit, si strukturë organizative e APRK-së dhe Komunës së Suharekës.
- 2) Praktika në punë iu ofron pjesëmarrësve mundësinë e fitimit të përvojës së nevojshme në mjedisin e punës për të filluar në një profesion të caktuar ose një fushë të karrierës.

Neni 3

Fushëveprimi

- 1) Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përcakton termet dhe kushtet e bashkëpunimit në mes MPMS/APRK dhe Komunës së Suharekës, në zhvillimin-realizimin e praktikës në punë për 15 (pesëmbdhjet) punëkërkues, për 6 (gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi, me pagesë mujore për pjesëmarrës në kompensim prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro.
- 1) Praktika në punë do të realizohet pranë zyrave përkatëse të Komunës së Suharekës

Neni 4

Baza e Bashkëpunimit

Baza e Bashkëpunimit për realizimin e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është legjislacioni i aplikueshëm i Republikës së Kosovës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës së Suharekës

- 1) Bashkëpunon me MPMS/APRK dhe strukturat organizative të saj rreth realizimit të praktikës në punë për 15 punëkërkues;
- 2) Bënë shprehjen e interesimit për të hyrë në partneritet përmes aplikimit përmes ueb-faqes së APRK apo duke vizituar Zyrat e Punësimit dhe procedon kërkesën sipas vendeve të lira të pasqyruara;
- 3) Nga lista e gjërë e kandidatëve së bashku me Zyret e Punësimit përkatëse bëjnë përzgjedhjen e punëkërkuesit;

- 4) Nënshkruan marrëveshjen në mes të punëdhënësit, punëmarrësit dhe Zyrës së Punësimit në emër të APRK, marrëveshje kjo për realizimin e masës e cila përmbanë të drejta dhe detyrime të palëve që marrin pjesë në implementimin e masës;
- 5) Mundëson mbrojtjen, sigurin dhe kushte të përshtatshme të punës për pjesëmarrësin sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe siguron ambiente të punës brenda administratës-departamenteve ku do të angazhohet praktikanti;
- 6) Siguron që praktikantët gjatë angazhimit të tij 6 (gjashtë) muaj do të përvetësojnë njohuritë dhe shkathëtsinë themelore të punës në zyrë-administrate dhe se do të jenë të gatshëm për tregun e punës pas përfundimit të angazhimit;
- 7) Bashkarisht me APRK-ZP përcakton departamentet se ku do të caktohen praktikantët varësisht nga profili i tij dhe përcaktimi i aktiviteteve për praktikë në punë;
- 8) Cakton personel nga administrata e Komunës së Suharekës i/e cili/a do të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes së punëkërkuarit të regjistruar që do të angazhohet në praktikë në punë, si dhe do të përcjellë angazhimin, mbikëqyrjes dhe udhëheqjen e praktikantëve mbi baza ditore;
- 9) Njofton APRK-ZP përkatëse lidhur me listën e vijueshmërisë së praktikantit mbi baza ditore dhe kërkon zëvendësimin e punëkërkuarit përkatës nga Zyra e Punësimit në raste të pakënaqësisë me pjesëmarrësin në periudhën provuese prej 10 (dhjetë) ditë prej fillimit të masës aktive;
- 10) Mundëson monitorimin e realizimit të masës praktikë në punë nga ana e këshilltarëve të Zyrës së Punësimit përkatëse dhe njofton MPMS/ APRK lidhur me sfidat dhe vështërsitë e pundshme gjatë realizimit të praktikës në punë;
- 11) Në përfundim të praktikës në punë, dhënie e letër reference për pjesëmarrësin për përvojën e punës të fituar;

Neni 6

Të drejtat dhe përgjegjësitë e MPMS/APRK-së

- 1) Të Sigurojë mjete financiare në shumen prej 22,500.00 € (njetetëdhjetë mijë e pesqind euro), për kompenzimin e punëkërkuarëve të angazhuar në praktikë në punë, në vlerë prej 250.00 euro në muaj për 1 praktikantë, si dhe bashkëpunon me Komunën e Suharekës, lidhur me realizimin e detyrave nga Marrëveshja e Bashkëpunimit në fjalë;
- 2) Regjistron kërkesat në SIMP, kërkesa këto që vijnë nga punëdhënësi, si dhe mundëson dhe bënë shpalljen pranë Zyrës së Punësimit;
- 3) Bënë listës e gjërë të kandidatëve sipas legjislacionit në fuqi për këtë procedurë, ku profili i punëkërkuarëve përputhet me kërkesat e punëdhënësit;
- 4) ZP në emër të APRK nënshkruan marrëveshjen për realizimin e masës e cila përmbanë të drejta dhe detyrime të palëve që marrin pjesë në implementimin e masës aktive, si dhe mundëson kompenzimi në formë të ndihmës financiare për të papunësuarin e regjistruar të angazhuar në

masën e praktikës në punë në vlerë prej 250.00 (dyqind e pesëdhjetë) euro për muaj, kompenzim ky që bëhet në xhirollogarinë bankare të pjesëmarrësit në praktikë në punë;

- 5) Përcaktimin e dinamikës së aktiviteteve lidhur me realizimin e praktikës në punë së bashku me Komunën e Suharekës;
- 6) Angazhimin e 1 praktikanti person me aftësi të kufuzura, angazhimin sipas mundësive edhe punëkërkues të cilët janë shfrytëzues të asistencës sociale të kategorisë II, të cilët gjatë kohës sa janë të angazhuar në projekt do t'iu ndërpritet asistenca sociale, kur kemi raste të tilla që i plotësojnë kriteret;
- 7) Monitorimi i masës praktikë në punë nga Zyra e Punësimit dhe ndërmarrja e masave korigjuese nëse është nevoja;
- 8) MPMS/APRK nuk është përgjegjëse për ndonjë shpenzim nga ndonjë dëmtim e paisjes në punë, shpenzimet nga aksidentet apo sëmundja e pjesëmarrësit gjatë implementimit të masës.

Neni 7

Ndërprerja, Ndryshimi dhe Vazhdimi

- 1) Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi mund të ndryshohet-vazhdohet vetëm me aneks- marrëveshje me shkrim, nënshkruar nga Palët, e cila i bashkangjitet marrëveshjes ekzistuese.
- 2) Në rast të mos respektimit të marrëveshjes nga pala në marrëveshje apo shkeljes së dispozitave ligjore në fuqi, marrëveshja mund të shkëputet njëanshëm pas lajmërimit paraprak të palës në marrëveshje 30 ditë përpara.
- 3) Marrëveshja e bashkëpunimit shfuqizohet në mënyrë automatike në raste të hyrjes në fuqi të ndonjë akti ligjor-nënligjor kur ndonjë pikë nga marrëveshja në fjalë është në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore të lartcekur.
- 4) Palët në marrëveshje dakordohen rreth shkëputjes së marrëveshjes nëse partneri dështon, pa pasur arsye, të përmbush cilindo obligim që duhet të përmbush dhe pas vërejtjes me shkrim nga pala tjetër në marrëveshje që të përmbush këto obligime 30 ditë përpara, ai prapë nuk arrin ta bëjë këtë apo që të ofrojë një shpjegim të kënaqshëm brenda afatit të arsyeshëm kohor të potencuar në vërejtjen e paralajmëruar 30 ditë përpara.
- 5) Nëse Partneri bën deklarime të rrejshme ose jo të plota, apo ai jep raporte që nuk pasqyrojnë realitetin.

Neni 8

Njoftimet dhe adresat

Çdo njoftim ose kërkesë e nevojshme apo që lejohet të jepet ose të bëhet sipas kësaj Marrëveshje, duhet të bëhet me shkrim. Njoftimi ose kërkesa e këtillë do të konsiderohet se është dhënë apo është bërë me rregull kur është dorëzuar personalisht, me anë të shërbimit postar të certifikuar, korierit të shpejtë, teleksit ose telegramit për palën të cilës duhet t'i jepet ose bëhet, në adresën zyrtare dhe të selisë së palës në marrëveshje.

Neni 9
Të ndryshme


1. Palët duhet të veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të marrëveshjes.
2. Dështimi i secilës nga Palët për të zbatuar një dispozitë të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, nuk do të thotë heqje dorë nga kjo apo ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshje nëse nuk denoncohet nga pala tjetër.
3. Shkresat dhe dokumentet tjera mbështetëse të cilat janë të aprovuara me nënshkrimin e palëve në marrëveshje i bashkëngjiten marrëveshjes së bashkëpunimit në fjalë.

Neni 10
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja


1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe fillon të implementohet nga data 01 Shkurt 2019 dhe përfundon me 31 Korrik 2019.
2. Marrëveshja e Bashkëpunimit hartohet në dy ekzemplarë origjinale në gjuhën shqipe për secilën palë nënshkruese nga një kopje.

PALET NENSHKRUERSE

z. Izedin Bytyqi,
Sekretar i Përgjithshëm


Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

z. Bali Muharremaj,
Kryetar i Komunës


Komuna e Suharekës



Prishtinë: Janar/2019